



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1049/4 prot.

Tiranë, më 01.09.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1049/2, DATË 17.07.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. LIGOR NOLE”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e z. Ligor Nole me nr. 1374 prot., datë 29.06.2020 ndaj veprimtarisë gjyqësore të magistrates I.M., gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan dhe me vendimin nr. 1049/2, datë 17.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Ligor Nole”, bazuar në nenin 122, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 204, pika 1, shkronja “j” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga: “Mihal Popi”, Ndërtesa 9, nr 8, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

